



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 13668/25

Nr. i fq. / Br. st -3-

Data: / Datum 01.04.25

VUSHTRRI - VUČITRN

NDËRMARRJA PUBLIKE LOCALE  
NPL PËRPARIMI SH.A Y VUSHTRRI  
Nr: Protokollit: 600/25  
Data: 02.04.2025



Komuna e Vushtrrisë

NPL "Përparimi" SH.A Vushtrri

02Nr. PB 424 /25  
Më, 01.04 2025

Bazuar në nenin 17, pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenin 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Planin pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022-2026, Rregulloren komunale në fuqi për menaxhim të mbeturinave me ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr. 21/25, datë 30.01.2025 për dhënien në menaxhim të Qendrës për grumbullim riciklim dhe paketim të mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh Komuna Vushtrri, me datën 01.04, 2025 arrihet kjo:

**MARRËVESHJE**  
**PËR DHËNIE NË MENAXHIM NË KOHË TË PA CAKTUAR TË QENDRËS PËR**  
**GRUMBULLIM RICIKLIM DHE PAKETIM TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË**  
**FSHATIN BUKOSH TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

**Palët e marrëveshjes:**

Komuna e Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson **z. Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme komuna).

NPL "Përparimi", Sh.a. në Vushtrri, të cilën e përfaqëson **z. Fadil Bahtiri**, Kryeshef Ekzekutiv (në tekstin e mëtejme "Përparimi").

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është dhënia në menaxhim dhe funksionalizimi të "Qendrës për grumbullimin riciklimin dhe paketimin e mbetjeve të riciklueshme në fshatin Bukosh Komuna e Vushtrrisë", Ndërmarrjes Publike Lokale "Përparimi në Vushtrri, konform me Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr. 21/25, datë 30.01.2025.

F. I. B

## Neni 2

### **Prona dhe asetet e komunës që epen në menaxhim**

- 2.1 Pjesa e ngastrës kadastrale nr. 70202010-0, në sipërfaqe prej 10000 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Bukosh,
- 2.2 Objekti në sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup> i ndërtuar në ngastrën e cekur në nënparagrafin paraprak,
- 2.3 Pajisjet: një makinë transportuese shpërndarëse (pikap kamionetë), një kamion për grumbullimin e mbeturinave, një shirit transportues, dy peshore matëse, një vinç i motorizuar, një vinç manual, katër makina balluese si dhe 100 (njëqind) kontejnerë të shpërndarë në terren për riciklim të mbeturinave.

## Neni 3

### **Fushëveprimi, kushtet e menaxhimit**

- 3.1 NPL "Përparimi", mbledh grumbullon riciklon dhe paketon mbeturinat e riciklueshme dhe që gjenerohen brenda territorit të komunës.
- 3.2 Për të ofruar funksionalizim të kënaqshëm të kësaj qendre NPL "Përparimi siguron personelin e nevojshëm të kualifikuar me shkathtësinë dhe trajnimin e duhur për t'i kryer shërbimet sipas kësaj Marrëveshje.
- 3.3 NPL "Përparimi" materialin e përdorur për riciklim mund ta tregtoj konform rregullave të tregut të lirë. Të hyrat që mund të krijohen nga shitja eventuale e produkteve do të derdhen në llogarinë e NPL "Përparimi".
- 3.4 NPL "Përparimi" merr për obligim që objektin dhe pajisjet të cilat i ipen në menaxhim të i përdor me nikoqirllëk - të i ruaj nga dëmtimi, të i mirëmbaj dhe të ofroj siguri fizike 24 orë. Në rast të ndonjë dëmtimi eventual, do të bartë barrën e përgjegjësisë materiale konform legjislacionit në fuqi.
- 3.5 Gjatë menaxhimit të kësaj qendre NPL "Përparimi merr përsipër pagesën e të gjitha shpenzimeve komunale – rrymë, ujë dhe shpenzime tjera eventuale të kësaj natyre.
- 3.6 NPL "Përparimi" nuk ka të drejtë të ia ndërroj destinimin, te jap me qira e as ta tjetërsoj në asnjë formë te personat e tretë pronën dhe asetet e qendrës që i merr në menaxhim, e as të i jap si kolateral në asnjë institucion/bankar financiar.
- 3.7 NPL "Përparimi nuk ka kurfarë detyrimi financiar ndaj komunës së Vushtrrisë në emër të menaxhimit të kësaj qendre gjatë gjithë periudhës kohore të cilën e ka në menaxhim.

## Neni 4

### **Përgjegjësitë e komunës**

- 4.1 Komuna përmes udhëheqësit të sektorit për menaxhim të mbeturinave, në cilësi të organit mbikëqyrës do të bëj mbikëqyrjen e menaxhimit të kësaj qendre nga NPL "Përparimi" dhe në fund të çdo viti kalendarik do të përpilojë raporte me shkrim për mbikëqyrjen dhe gjendjen e konstatuar. Një kopje e raportit duhet t'i dorëzohet NPL "Përparimi" dhe kryetarit të komunës.
- 4.2 Komuna ka të drejtë po ashtu që përmes komisionit tre anëtarësh nga zyrtarë të saj t'i inspektojë në çdo kohë lokacionet e parapara në këtë marrëveshje në të cilat i kryen shërbimet nga NPL "Përparimi" performancën për shërbimet e kryera, zbatimin e rregullave dhe standardeve të kërkuara.

F.I. B

4.3 Komuna e Vushtrrisë mban të drejtën e shkëputjes në çdo kohë të kësaj marrëveshje në rast se NPL "Përparimi" nuk bënë menaxhimin e qendrës konform kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Në këtë rast komuna e Vushtrrisë do ta paralajmëroj me shkrim NPL Përparimi së paku 30 ditë kalendarike.

### **Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje lidhet për kohë të pa caktuar dhe mund të përfundoj vetëm me vendim të kuvendit të komunës së Vushtrrisë.

### **Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kontestet që ndërlihen me menaxhimin e përcaktuar në kuadër të kësaj marrëveshje zgjidhen në radhë të parë me mirëkuptim përmes takimeve të përbashkëta. Nëse nuk arrihet zgjidhja çështja duhet të shkallëzohet si vijon:

- 6.1 Nëse çështja mbetet e pazgjidhur, ankesa/t duhet t'i parashtrohen me shkrim bordit të drejtorëve të NPL "Përparimi", anëtarët e të cilit do ta shqyrtojnë çështjen brenda 5 ditëve të punës.
- 6.2 Nëse çështja nuk është zgjidhur, atëherë ankesa/t, së bashku me dëshmitë përkatëse, duhet t'i përcillen me shkrim Komisionit komunal të aksionarëve përkatës. Ankuesit do t'i jepet një shqyrtim përfundimtar dhe një përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve të punës.
- 6.3 Nëse asnjë zgjidhje nuk mund të arrihet midis NPL "Përparimi" dhe komunës, çështja duhet të iniciohet në gjykatën kompetente.

### **Neni 7 Ndërprerja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të ndërpritet me pajtimin e të dyja palëve me shkrim ose nëse cilado palë jep njoftim me shkrim, dy (2) muaj para se të ndërpritet.

### **Neni 8 Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

**Neni 9**  
Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri (4) kopje origjinale, dy (2) për komunën dhe një për NPL "Përparimi".

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës



**Fadil Bahtiri**

Kryeshf Ekzekutiv  
NPL "Përparimi" SH.A

